



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT  
BORDI DREJTUES

Nr. 305 prot

Tiranë më 19/12 / 2024

PROCESVERBAL  
MBLEDHJE BORDI

( Datë, 18/12/2024 )

**Të pranishëm nga Bordi Drejtues:** Z.Vasil Tole, Z.Alfred Lako, Znj.Jonila Godole, Znj.Enriketa Pandelejmoni, G.Peshkëpia.

**Të pranishëm nga Instituti :** Z.Çelo Hoxha

**Tema e mbledhjes:** Diskutim mbi deklarin e interesave private të anëtarve të Bordit dhe diskutime të tjera.

*Hapet mbledhja*

**J.Godole:** Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen. Jemi mbledhur për të diskutuar mbi situatën tonë në lidhje me deklarin e interesave private, pas shkresës së kthyer nga ILDKPKI. Fillojmë me Enin meqë Eni e kërkoi që të bëhej kjo mbledhje.

**E.Pandelejmoni:** Përshëndetje, unë e kam shqetësim këtë pjesën e deklarin që në momentin që na ka mbaruar mandati por që ne kemi vazhduar të mblidhemi dhe të jemi një bord funksional. Është një shqetësim pasi përveç komunikimeve verbale që mund të kenë pasur nga instituti në lidhje me këtë çështje ,tani që erdhi shkresa nuk e di sesi mund te veprohet i bie që ne kemi deklarinet pa bërë dhe kam merak nëse marrim penaltete për këtë.

Gjithashtu për komunikimet që kemi pasur me Çelon për shkresat e dërguara Kuvendit, mendoj se janë çështje sensitive dhe ne duhet të vihemi më dijeni para se të dergohen këto shkresa. Këto janë qëndrime institucionale dhe jo qëndrime personale, dhe janë çështje që kanë ndjeshmëri, ndaj duhet të jemi të përfshirë edhe ne si Bord. Këto janë dy shqetësimet e mia.

**J.Godole:** Faleminderit Eni. Vazhdojmë fjalën e ka Alfredi.

**A.Lako:** Kjo çështja e deklarimeve është një telash pasi duhet të bësh gati shumë dokumenta që kërkohen, megjithëse unë mendoj se ne nuk jemi në ato pozita që të bëj raportime të tilla.

**J.Godole:** Faleminderit, po edhe unë jam shprehur se dua të largohem nga Bordi por e kemi shtyrë për mos penguar punën e institutit. Ne kemi komunikuar me ju me emaile dhe ndoshta duhet ta kishit marre pak më seriozisht këtë çështje që ne të kishim marrë një informacion më shpejt për këtë çështje.

**Ç.Hoxha:** Deklarimi i interesave private bëhet para fillimit të detyrës , behet gjatë kryerjes së detyrës çdo vit dhe pas largimit nga detyra. U emëruat në Bord dhe pas njoftimeve filluat me deklarinimet. Edhe në përfundim të mandatit tuaj 5 vjeçar u njoftuat dhe ju plotësuat deklaratat tuaja sipas ligjit për plotësimin e deklaratës pas përfundimit të detyrës. Juridikisht ju keni plotësuar deklaratat sipas afateve të përcaktuara. Gjithë ngërçi ka ardhur nga Kuvendi i cil nuk ka zgjedhur Bordin e ri. Ju keni vazhduar duke plotësuar një boshllëk të cilin e ka lënë Kuvendi , dhe për të mos penguar punën e institutit. Juridikisht nuk ka shumë zgjidhje por ju mund të vazhdoni të bëni deklarinimet përsëri.

**E.Papa:** Edhe nga shkresa e ILDKPKI ne jemi në vijushmëri pasi ne kemi vazhduar të funksionojme si Bord, ndaj duhet të bëjm dhe deklarime.

**Ç.Hoxha:** Ju vijuat me idenë se do të vazhdonit dhe dy apo tre muaj sa të zgjidhej bordi tjetër por që vijuat deri në këtë moment pasi spo zgjidhet bordi i ri.

**E.Papa:** Ndaj u dërgua dhe shkresa te ILDKPKI dhe u bë institucionale ngaqë në kemi vazhduar kaq gjatë.

**Ç.Hoxha:** Unë sa herë kam shkuar në Kuvend e kam shprehur shqetësimin për zgjedhjen e Bordit të ri por nuk janë plotësuar vendet me kandidaturat për të zgjedhur anëtarët e rinj.

**G.Peshkëpia:** Unë e kam të vështirë të plotësoj përsëri ato deklarata, por si të vendoset do të veprojmë.

**V.Tole:** Unë nuk kam shqetësim për këtë temë pasi unë bëj deklarinim këtu ku unë punoj.

**J.Godole:** Ne kishim nje takim këto ditë me shefen e kabinetit në Kuvendit dhe do të diskutonim këto çështje por që ky takim na u shty për ditët ne vijim. Pas takimit unë do të marr një vendim. Nëse vazhdohet kështu unë do të tërhiqem, do të jap dorheqjen.

Dakort me diskutimin e deklarinimit të interesave privat, ka diçka tjetër?

**Ç.Hoxha:** Po unë kam për të diskutuar atë pjesën e email-ve që ju keni dërguar. Unë i kam lexuar me vëmendje shqetësimet e Bordit. Jam i paqartë nëse shqetësimi buron nga ana procedurale e dërgimit të shkresës apo për shkak të përmbajtjes së dokumentit. Unë kam vepruar në bazë të nenit 5 , pika i , për bashkpunimin me institucionet e tjera. Unë kam dërguar informacion ashtu si ju kam dërguar edhe institucioneve të tjera.

Tek detyrat e Bordit, ligji parashikon miratimin e raportit vjetor, dhe jo raportime të miat çdo javë apo çdo muaj. Bordi i ka detyrat të përcaktuara. Kjo ishte nga ana procedurale.

Nga ana përmbajtësore për mua nuk është çështje delikate puna që bën instituti. Instituti bën nje punë specifike, duke studiuar një periudhë të caktuar historike. Dokumenti është një raport mbi punën e institutit të cilin bordi e ka miratuar. Janë 12 vëllimet e enciklopedisë , është libri Lufta civile nga të cilët janë nxjerrë këto konkluzione shkencore që janë përmbledhur në një raport dhe i dërgohen Kuvendit për të orientuar Kuvendin drejt një konkluzioni shkencor që ne kemi arritur. Këtu është rasti pëe shifrën e përgjithahme e të përsekutuarve sipas vëllimeve të enciklopedisë

dhe shifren e te vrarëve nga komunistet gjatë periudhës së luftës. Këto shifra duhet të dihen dhe të evidentohen. Kemi evidentuar krimet e luftës civile. Janë rreth 4 mijë viktima nga kjo luftë. Për këtë është bërë botim nga Instituti i Historisë i cili varet nga Akademia e Shkencave, me 100 faqe që flet për luftën civile. Unë nuk shof diçka delikate këtu.

Ne botojmë shifra, dokumete zyrtare ku i pari thotë janë 5 mijë dëshmorë por publikisht tjeri janë 28 mijë, dhe i kërkojnë qeverisë që të zgjerojë përkufizimin e dëshmorve që të arrijnë targetin që duan.

**E.Pandelejmoni:** Nuk është qëllimi për tu kapur me detaje juridike. Meraku im është se është ndryshuar ligji. Problemi është institucional. Në momemtin që është ndryshuar ligji i ISKK, ku është amenduar periudha dhe ti flet për periudhën para 1944 , nuk është ky tagri i institucionit. Kjo është periudha e luftës dhe ne duhet të vihemi në dijeni se është dhe një periudhë që nuk e kemi për studim.

**Ç.Hoxha:** Sipas cilit nen do viheshit në dijeni? Në raportin vjetor do viheshit në dijeni se sa shkresa janë dërguar , ku janë dërguar etj.

**E.Papa:** Sipas nenit 13, pika a thotë që bordi do të shqyrtojë gjithë matrialet e institucionit, nuk është vetëm raporti. Por unë mora shkasë nga sensitibiteti i kësaj çështje, ku ti nuk e ke për tagër të japësh numrin e dëshmorve, kjo është pjesë e luftës dhe këtë nuk e ke tagër për tu marrë me atë periudhë.

**Ç.Hoxha:** Ligji i dëshmorit është dhënë ne vitin 1969, dhe ne merremi me propagandën që ka bërë partia komuniste dhe pastaj shkojmë të pjesa e dëshmorve.

**E.Pandelejmoni:** Ne mund të kemi mendimet personale por ky është qëndrim institucional ndaj ne duhet të na vije në dijeni për këto shkresa që dërgohen. Këtë diskutim e bëmë edhe mbledhjen e kaluar që ne duhet të vihemi në dijeni për këto komunikime.Kjo është procedurë institucionale.

**Ç.Hoxha:** Patjetër që do të vihemi në dijeni. Ti nuk bie dakort me anën procedurale apo apo përmbajtjen?

**E.Pandelejmoni:** Unë po them për anën procedurale, pasi ne diskutuam në mbledhjene kaluar që të vihemi në dijeni, nuk më duket korrekte që të dërgohen këto rekomandimeve pa na vënë në dijeni.

**Ç.Hoxha:** Më thuaj çfarë klauzole ligjore kam shkelur dhe që thotë që duhet të raportoj për këto komunikime?

**E.Pandelejmoni:** Unë ta kam cituar neni 13, pika a, e ligjit të institutit. Lexoje dhe e shohim se çfarë thotë.

**Ç.Hoxha:** Neni 13 flet për detyrat e drejtorit ekzekutiv. Pika e parë thotë se drejtori drejton institucionin. Pika tjetër thotë se drejtori përgatit matrialet dhe ja paraqit bordit dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Bordit.

**E.Pandelejmoni:** Po për këtë pikë e kam fjalën dhe këto matrialet duhet të kalojnë në bord.

**Ç.Hoxha:** Kjo pikë nuk thotë të gjitha dokumentat që prodhon institucioni duhet ti miratojë bordi. Se çfarë miraton bordi janë në nenin 11 të këtij ligji.

**E.Pandelejmoni:** Në rregull, por unë kërkova që në momentin që nuk i ke në harkun kohor të studimit mos merremi me atë periudhë, përderisa është ndryshuar ligji për periudhën kohore të studimit. Nëse unë jam gabim unë tërhiqem por unë kështu e mendoj.

**Ç.Hoxha:** Unë nuk kam shkelur ndonje nen të ligjit. Nëse dhe të tjerët mendojnë se kemi shkelur një ligj mund ti drejtohem i instancave të tjera ose të kërkojmë asistencë juridike për këtë çështje. Unë nuk kam dhënë një vendim në emër të Bordit apo të dërgoj shkresë në emër të Bordit. Unë kam dërguar shkresë në emër të institutit dhe një pikë e detyrave të ligjit thotë se drejtori përfaqson institucionin me të tretët.

**J.Godole:** Po në rregull po shof që secili i përmbahet qëndrimit të tij për këtë çështje. Por në të ardhmen duhet ta marrësh parasysh edhe shqetësimin e Enit meqënëse është ngritur si shqetësim edhe ne mbledhje të tjera, dhe kjo edhe për shkak ndryshimeve ligjore.

**Ç.Hoxha:** Periudha ligjore nuk është ndaluese pasi propaganda e luftës është bërë pas vitit 1944 e në vazhdim.

**J.Godole:** Historia ka disa variante dhe për këto çështje ka qëndrime të ndryshme. Duhet pasur parasysh që ne si bord qëndrojmë për të mos penguar punën e institutit ndaj duhen pasur parasysh edhe keto këshilla. Nëse nuk ka gjë tjetër për të shtuar unë ju falenderoj dhe mbledhjen e mbyllim për sot.

**Jonila Godole Zv. Kryetar.....**

**Enriketa Pandelejmoni Anëtar.....**

**Gëzim Peshkëpia Anëtar.....**

**Vasil Tole Anëtar .....**

**Alfred Lako Anëtar.....**

**Mbajti procesverbalin**

**Liljana Aliko**

